Raporti i garës së NIVELIT B

Data: 16 maj 2026
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës së Kosovës
Mbështetës: Ministria e Sportit dhe Rinisë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Kompania Liri dhe Alickaj Print.

1. Përshkrimi

Në kuadër të kalendarit zyrtar të aktiviteteve të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, më 16 maj 2026, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë u organizua Gara e Nivelit B në gjimnastikën artistike për femra dhe meshkuj. Kjo garë kishte për qëllim të ofrojë mundësi garimi për gjimnastët që kanë kaluar nivelin fillestar, pra janë më të mire krahasuar me nivelin C dhe janë në fazën e avancimit drejt garave më të larta të federatës.
Në garë morën pjesë gjithsej **93 gjimnastë** nga **11 klube** të Kosovës.

Viti i lindjes:	Numri i garuesëve:
2020	1
2019	3
2018	7
2017	17
2016	18
2015	11
2014	10
2013	8
2012	9
2011	2
2010	4
2009	1
Totali 93 garues	

Garuesit u paraqitën me ushtrime të lira, jo me kompozime obligative, sipas kërkesave teknike të përcaktuara nga komisioni i garave dhe gjyqtarët të cilat janë paraqitur në direktivat e garës dhe u janë dërguar klubeve me kohë. Në konkurrencën e femrave garat u zhvilluan në disiplinat parter, tra dhe kapërcime, ndërsa në konkurrencën e meshkujve në parter dhe kapërcime. Përveç medaljeve sipas disiplinave, u shpallën edhe fituesit në shumëgarësh për secilën kategori. Shumëgarëshi llogaritej me mbledhjen e pikëve në të gjitha disiplinat.

Klubet pjesëmarrëse ishin:
Akademia e Gjimnastikës Ardhmëria,
Klubi i Gjimnastikës Elita,
Klubi i Gjimnastikës Omnisport,
Klubi i Gjimnastikës Kulina,
Klubi i Gjimnastikës Skenderaj,
Klubi i Gjimnastikës Vushtrria,
Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Gjilan,
Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Viti,
Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova,
Klubi i Gjimnastikës Gjimnastika Malishevë.
dhe nga Shqipëria Xheni Gjimnastikë.

2. Gjyqtaria

Vlerësimi i ushtrimeve u realizua nga gjyqtarët e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, të organizuar në **tre panele gjyqtarësh**. Vlerësimi u bë në përputhje me Kodin e Poentimit të Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (FIG) dhe direktivat e miratuara nga bordi ekzekutiv për këtë nivel gare. Gjatë garës nuk u evidentuan probleme që do të ndikonin në rrjedhën e vlerësimit.
Në garë kishte edhe formular për ankesa, por nuk u plotësua asnjë formular i tillë nga klubit, që dmth ishin të kënaqur me rezultate.

Përbërja e gjyqtarisë:

Parter: Abeliana Bregu, Amir Tahiraga, Arlind Shaqiri, Drinesa Qerimi (vrojtuese) dhe Fitore Rudari (vrojtuese)
Tra: Doruntinë Ibrahimi, Vilëza Zeqiri, Qëndresa Halili dhe Jara Hasolli (vrojtuese)
Kapërcime: Ard Kryeziu dhe Lisa Zeqiri

Rregullimi i sallës u bë një ditë para garës nga personat e angazhuar nga FGJK duke u ndihmuar nga organizatorët, ndërsa gjatë tërë ditës së garës ishin të angazhuar vullnetarë për orientimin e garuesve, mbajtjen e rendit dhe ndihmën gjatë rotacioneve.

3. Ecuria e garës.

Aktiviteti filloi zyrtarisht në ora **10:00** me fjalinë hyrëse të kryetarit Shkumbin Maqastena, dhe me hyrjen në garë të grupmoshave të vogla, ndërsa pjesa e dytë e garës vazhdoi nga ora **13:00**, sipas orarit të planifikuar, me sportistet më të rritura. Garuesit u organizuan në rotacione sipas grupmoshave dhe disiplinave. Të gjitha paraqitjet u realizuan sipas planit të punës, ndërsa aktiviteti përfundoi në ora **16:30**.

Hyrja në sallën e garës ishte e rezervuar vetëm për garuesit, trajnerët, gjyqtarët dhe stafin organizativ, ndërsa prindërit dhe shikuesit e ndoqën garën nga hapësira e dedikuar për publikun. Gara u karakterizua me një atmosferë sportive gjatë gjithë ditës.
Me përfundimin e garave paradite, u ndanë medaljet për vegla dhe shumëgarësh e pastaj filluan garat e pasditës. Para secilës disiplinë gjimnastët kishin kohë të mjaftueshme për nxemje në vegla.
FGJK kishte siguruar ushqim dhe pije per gjytarët, trajnerët dhe të gjithë stafin.

Në këtë garë prezent ishte edhe Kryqi i Kuq i Kosovës për raste të asistencës në raste të lëndimeve. Në këtë garë për fat të mirë nuk kishe ndonjë lëndim të gjimnasteve.

Orari i garës paradite:

Rotacioni 1:	
Parter:	Garon viti i lindjes 2020 - 2018
Tra:	Garon viti i lindjes 2017
Kapërcime:	Garon viti i lindjes 2016
Rotacioni 2:	
Parter:	Garon viti i lindjes 2016
Tra:	Garon viti i lindjes 2020 - 2018
Kapërcime:	Garon viti i lindjes 2017
Rotacioni 3:	
Parter:	Garon viti i lindjes 2017
Tra:	Garon viti i lindjes 2016
Kapërcime:	Garon viti i lindjes 2020 - 2018

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Orari i garës pasdite:

Rotacioni 1:	
Parter:	Garon viti i lindjes 2015
Tra:	Garon viti i lindjes 2014 - 2013
Kapërcime:	Garon viti i lindjes 2012 - 2009
Rotacioni 2:	
Parter:	Garon viti i lindjes 2012 - 2009
Tra:	Garon viti i lindjes 2015
Kapërcime:	Garon viti i lindjes 2014 - 2013
Rotacioni 3:	
Parter:	Garon viti i lindjes 2014 - 2013
Tra:	Garon viti i lindjes 2012 - 2009
Kapërcime:	Garon viti i lindjes 2015

4. Përfundimi

Gara e Nivelit B 2026 u zhvillua me sukses dhe përmbushi objektivat e saj. Pjesëmarrja e 93 gjimnastëve nga 11 klube dëshmoi interesimin e vazhdueshëm të klubeve për zhvillimin e sportistëve në këtë nivel të garimit.

Federata e Gjimnastikës e Kosovës falënderon të gjitha klubet pjesëmarrëse, trajnerët, gjyqtarët, stafin organizativ, vullnetarët dhe të gjithë bashkëpunëtorët që kontribuan në realizimin me sukses të kësaj gare.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Disa foto nga gara:













FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Rezultatet e garës mund të gjenden në linkun:

https://fgjk-kos.com/garat-vendore/

Data e raportit: 29.06.2026
Prishtinë